



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar Received / Delivered	09-02-2023	viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SK/1660/2023			115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.43/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.43/2023 të datës 11.01.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati Malsia e Re, rruga "Sali Shabani", në Prizren, kundër Vendimit me Nr. 01-060/01-0171338/22 të datës 06.12.2022 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. *Refuzohet si pa bazuar* ankesa me numër A.nr.43/2023 e datës 11.01.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. *Mbetet në fuqi* Vendimi me Nr. 01-060/01-0171338/22 i datës 06.12.2022 i Kryetarit të Komunës së Prizrenit.

A r s y e t i m

Spitali i Përgjithshëm i Prizrenit "Prim.Dr. Daut Mustafa", më datë 25.08.2022 ka shpallur konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës në kohë të caktuar për pozitën Drejtor i Administratës dhe Shërbimeve të Përbashkëta. Tutje sipas Vendimit me Nr. Amz.1455 të datës 07.11.2022 të lëshuar nga Drejtoresha Ekzekutive në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren, ankuesi pranohet në marrëdhënia punë në pozitën e lartcekur, ndërsa më datë 07.11.2022 ka nënshkruar edhe kontratës me numër të kontratës 1455 për këtë pozitë.

Ankuesi i punësuar në Komunën e Prizrenit në pozitën Auditor i Brendshëm sipas Akt Emërimit të datës 22.10.2014, më datë 07.11.2022 ka parashtruar tek Kryetari i Komunës së Prizrenit kërkesë për pezullimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil.

Kryetari i Komunës së Prizrenit më datë 06.12.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 01-060/01-0171338/22 përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 01-060/01-0171338/22 të datës 06.12.2022 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, përmes postës më datë 06.01.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 11.01.2023 dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.43/2023 me numër protokolli 169/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.01.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Prizrenit. Ndërsa Këshilli më datë 08.02.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 169/2023 e datës 11.01.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 01-060/01-0171338/22 të datës 06.12.2022 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit; Zarin; Plotësimin e ankesës më datë 12.01.2023; Konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës në kohë të caktuar i datës 25.08.2022 për pozitën Drejtor i Administratës dhe Shërbimeve të Përbashkëta të shpallur nga Spitali i Përgjithshëm i Prizrenit "Prim.Dr. Daut Mustafa"; Kontratë Pune për kohë të caktuar me Nr. 1455 datës 07.11.2022; Vendimin me Nr. amz.1455 të datës 07.11.2022 të Drejtoreshës Ekzekutive në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren; Akt Emërimit të datës 22.10.2014; Kërkesën për pezullim të marrëdhënies së punë e parashtruar më datë 07.11.2022 nga ankuesi për Kryetarin e Komunës dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore; Vendimin me Nr. 01-110-009152 të datës 17.01.2018; Vendimin me Nr. 01/011-009323 të datës 17.01.2018; Vendimin me Nr.01-030-194056/01 të datës 12.01.2022; Vendimin me Nr. 01-112-70244 të datës 17.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 01-060/01-0171338/22 të datës 06.12.2022 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, pretendon se vendimi është nxjerr me shkelje të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjit për Zyrtarët Publikë, sepse dispozitivi i vendimi është i paqartë dhe i pakuptueshëm, nuk janë marr për bazë dispozitat e nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh faktin që pozita Drejtor i Administratës dhe Shërbimeve të Përbashkëta e shpallur nga Spitali i Përgjithshëm i Prizrenit "Prim.Dr. Daut Mustafa" është shpallur mbi bazë të nenit 66, 67, 68 dhe 69 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 8 dhe 10 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, rrjedhimisht duke ju referuar Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht nenit 2 paragrafi 2, i cili përcakton se: *"Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës"*, Kolegji i Këshillit konstaton së pozitë Drejtor i Administratës dhe Shërbimeve të Përbashkëta dhe çdo pozitë tjetër në kuadër të institucioneve që ofrojnë shërbime në fushën e shëndetësisë i përkasin kategorisë së nëpunësve të shërbimit publik, siç parashihet me paragrafin 4 të nenit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike"*, ndërlidhur me këtë neni 64 paragrafi 1 i këtij ligji, përcakton se: *"Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës"*, ndërsa paragrafi 6 i nenit 68 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *"Nëpunësit e shërbimit kategorizohen në personelin drejtues, në personelin profesional dhe në personelin e brendshëm të shërbimeve të përbashkëta"*.

Andaj lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji i Këshillit, marr parasysh dispozitat e lartcekura, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se me rastin e shqyrtimit të kërkesës së tij nuk janë marr për bazë dispozitat e nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, ju referuar dispozitat ligjore që rregullojnë pezullimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, respektivisht sipas nenit 55 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *"1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, i cili bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; apo 1.2. me kërkesë të nëpunësit civil"*, ndërlidhur me pezullimin sipas detyrës zyrtare, Kolegji i Këshillit, konstaton se kjo mund të bëhet vetëm në rastet e parashikuara me nenin 56 të këtij ligji, i cili përcakton se: *"Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji; 1.2. kur emërohet në një nga funksionet e parashikuara në paragrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 3 të këtij ligji, për periudhën përkatëse të emërimit; 1.3. transferohet, për nevoja të institucionit apo shtetit, në një organizatë ndërkombëtare, qeveri të huaj apo në një institucion ndërkombëtar, për periudhën përkatëse; 1.4. kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë parandaluese penale pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi; 1.5. deklarohet i zhdukur me vendim të formës së prerë të gjykatës, deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim të formës së prerë të gjykatës; 1.6. regjistrohet, sipas ligjit, si kandidat për zgjedhjet qendrore e lokale, për periudhën nga regjistrimi deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar apo deri në përfundim të mandatit; 1.7. nëse ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi, që deklarohet nga vetë nëpunësi, sipas ligjit të veçantë, deri në transferimin e tij"*

në një pozite tjetër, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji; 1.8. gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimit për nevojat e institucionit për periudhën që ndjek këtë program me shkëputje nga puna; 1.9. në raste të tjera, të parashikuara shprehimisht me ligj”.

Rastit të cilit i referohet ankuesi se nuk është marr për bazë neni 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit, ju referuar rasteve kur mund të bëhet kjo, respektivisht kjo mund të bëhet vetëm në rastet ku nëpunësi civil emërohet në një nga funksionet e parapara me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Rrjedhimisht sipas nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: “Ky ligj nuk zbatohet për: 1.1. funksionarët publikë; 1.2. funksionarët publikë me status të veçantë”, ndërsa termi funksionar publikë është përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni, i cili përcakton se: “2. Funksionarë publikë, në kuptimin e nënparagrafit 1.1 të këtij neni, janë: 2.1. të zgjedhurit; 2.2. anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre; 2.3. funksionarët e emëruar nga Kuvendi apo nga Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura”. Në këtë rast ankuesi nuk është emëruar në njërin nga funksionet e përcaktuara me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, mirëpo i njëjti ka themeluar një marrëdhënie pune për pozitë në nëpunësit të shërbimit publikë, rrjedhimisht nëpunësit i shërbimit civil nuk i pezullohet marrëdhënia e punë në Shërbimin Civil në rast të emërimit në një pozitë të Nëpunësit të Shërbimit Publikë.

Nga të cekurat si më lartë, Kolegji i këshillit, konstaton se në rastin konkret të ankuesit nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore të cekura si më lartë për pezullimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil të ankuesit, si rrjedhojë, kërkesa e tij është e pabazuar, ndërsa lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar me ankesën respektivisht Vendimit me Nr. 01-060/01-0171338/22 të datës 06.12.2022 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, Kolegji i Këshillit, konstaton se Kryetari i Komunës së Prizrenit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 01-060/01-0171338/22 të datës 06.12.2022 ka vepruar në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ngase ky vendim i përmban të gjitha elementet e aktit administrative në kuptim të nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa arsyetimi i vendimit të konstatuar është në pajtim të plotë me nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që vendimi i kontestuar me ankesë është i ligjshëm, ndërsa pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Theksuar i më lart, e duke bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetar i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.43/2023, datë 09/02/2023

Avdol BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

[Signature]
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.